



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 30 shtator 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1286_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 126-5 ZK Sofali, me kapacitet të instaluar prej 3 kW në Komunën e Prishtinës, të pranuar me datë 25.08.2020 nga aplikuesi personi fizik Besim Latifaj, me adresë: "Sofali" Komuna Prishtinës, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 30 shtator 2020 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit personit fizik Besim Latifaj për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulimin e objektit në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 126-5 ZK Sofali, me kapacitet të instaluar prej 3 kW në Komunën e Prishtinës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi personi fizik Besim Latifaj me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR-90148999 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtoj kërkesë në KEDS SH.A., për pranimit teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE** do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi personi fizik Besim Latifaj** do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.


Arsyetim




- o ZRRE, me datë 25.08.2020 nga aplikuesi personi fizik Besim Latifaj, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 126-5 ZK Sofali, me kapacitet të instaluar prej 3 kW në Komunën e Prishtinës.
 - o Aplikuesi, së bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 5400 të datës 17.07.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Vendimin Nr. 05-353/01-90226/20 dt. 20.08.2020 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Prishtinës.
 - o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit personit fizik Besim Latifaj dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 126-5 ZK Sofali, me kapacitet të instaluar prej 3 kW në Komunën e Prishtinës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së,


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfi, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Prishtinës,
- KEDS SH.A., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.